

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BIT_ITALIAN TECHNOLOGY FOR BUILDING INDUSTRY” SH.P.K

Kreu I



Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Bazuar në Kushtetutë dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, në ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 “Për Rregjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar dhe ne Ligj nr 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” :

Sot më 26/01/2017 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “BIT_Italian technology for building industry” Sh.p.k

1. Themeluesit e shoqërisë janë:


- a) **Z. Sabino Rutilli**, i biri i Antonios, lindur me 14/07/1961 në Bari, banues Via Alfredo Giovine 43, Bari, Itali, identifikuar me numrin e kartës së identitetit nr AU 4769932
- b) **Z. Ignazio Cassano**, i biri i Michele, lindur me 24/12/1973 në Bari, banues në Modugno, Via Contrada Conella 38/D, Bari, Itali, identifikuar me numrin e kartës së identitetit nr. AY 2785886
- c) Shoqëria "**MS Law & Business**" **Sh.p.k.** (Person Juridik), me seli në L. Qemal Stafa, Blv. Zogu I, Nr 44, Shkodër, me numer Unik të Identifikimit (NUIS) L67001005H, i përfaqësuar nga administratori, **Z. Michele Sorgente** , identifikuar me numrin e kartës së identitetit AR3480449

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Përpunim dhe ndërtim në strukturë metalike; Import-Export;
- Përpunimi dhe tregtimi i hekurit për ndërtim; Import-Export;
- Shitjet e rrjetave/zgara metalike, profile dhe fletë metalike, si dhe prodhimin dhe shitjen e betonarmes të të gjitha tipeve;
- Punime të përgjithshme të ndërtimit të ndërtesave të të gjitha llojeve, përfshirë sistemet e tyre dhe punëve të lidhura e ndihmëse;
- Punimet e ndërtimit dhe instalimeve në përgjithësi, të tilla si vepra të infrastrukturës, mirëmbajtje rutinë, të jashtëzakonshme, ruajtje dhe restaurim, ndërtim/rinovimin dhe planifikim urban;
- Shitja e materialeve dhe pajisjeve për ndërtim;



- Prodhimi i betonit dhe produkteve gjysmë të gatshme për ndërtimin, si dhe elementeve të parafabrikuara për ndërtesa civile dhe industriale;
- Prodhimi i inerteve dhe lëndëve të tjera që nxirren nga guroret, si dhe rikuperimi dhe/ose ripërdorimi i tyre për ndërtimin në përgjithësi;
- Blerja dhe shitja, edhe e pjesëshme, menaxhimi, administrimi dhe prokurimi i pasurive të palujtshme edhe nëse jo të destinuara për arritjen e objektit të saj kryesor;
- Transporti për llogari të të tretëve, që do të kryhet me mjetet e tyre dhe / ose palëve të treta;
- Gjetja, organizimi, transferimi dhe ekzekutimi i transportit të të gjitha llojeve, sistemeve, produkteve ose të mallrave;
- Aktiviteti specifik i transportit kombëtar dhe ndërkombëtar, me mjetet e veta dhe / ose palëve të treta;
- Menaxhimi i depozitave për mallrat dhe / ose produktet që kanë të bëjnë me sektorin e ndërtimit.
- Kompania gjithashtu mund të realizojë dhe të furnizojë me mjete, duke përfshirë dhe ato informatike, individuale dhe / ose të rrjetit, dhe modele për menaxhimin e integruar për të gjitha shërbimet dhe punimet më lart ilustruar në mënyrë që të zgjidhë/ofrojë shërbim për të gjitha kërkesat e klientëve të saj.
- Për ndjekjen e qëllimit të saj, kompania do mund të përfitojnë nga çdo lehtësi fiskale, financiare, për sigurimet shoqërore dhe kredi, të parashikuata nga ligjet në fuqi si vendase ashtu dhe të huaja.

Kompania mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në gjykimin ekskluziv të organit drejtues, për zbatimin dhe arritjen e qëllimit dhe vetëm për këtë qëllim mund të:

- Zhvillojë operacione tregtare dhe industriale, bankare, hipotekare, ekonomike dhe të pasurive të patundshme;
- të përdorë çdo formë të financimit me bankat, kompani kreditimi duke ofruar garancitë e favorshme reale dhe personale;
- të pranojë pjesëmarrje dhe interesa në kompani dhe ndërmarrje.

Neni 3

Kohëzgjatja

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit pranë QKB.

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: “Komuna e Parisit”, Pall. Haxhiu, Shk 3, AP 3/1/3/D, Zone Kadastrale Nr.8260, Numer Pasurie 6/675+3-7, Tirane

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,360,000 Lekë (njemilion e treqind e gjashtedhjetë mijë lek) , ekuivalentja e 10,000 (dhjetë mijë) Eur
- (2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a. Ortaku themelues **Rutilli Sabino**: Zotërues i 1(nje) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **45%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b. Ortaku themelues **Ignazio Cassano**: Zotërues i 1(nje) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **45%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - c. Ortaku themelues **“MS Law & Business” Sh.p.k** : Zotërues i 1(nje) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **10%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve **Rutilli Sabino** dhe **Ignazio Cassano** është në para dhe nuk është paguar.

Kontributi i **“MS Law & Business” Sh.p.k** është në natyrë, sipas marrveshjes mes ortakëve bashkangjitur këtij statuti, në të cilin **“MS Law & Business” Sh.p.k** nuk duhet të derdhë para, as për kapitalin themeltar, as për rritje eventuale të kapitalit, duke siguruar që perqindja fillestare nuk ulet, qoftë dhe për mbulim humbjesh; përveç kësaj **“MS Law & Business” Sh.p.k**, mund të dalin në cdo moment nga shoqëria dhe pa asnjë motiv, edhe në të gjitha rastet pa paguar asgjë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Ortakët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e

kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nëse merret vendim nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën mase ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë, me përjashtim të "**MS Law & Business**" Sh.p.k , sipas nenit 5 të këtij statuti.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kreu III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8


Organi vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërine për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likujdvesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



- e) Percaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së verimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin dhe mbledhjen vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kourumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të



votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kourumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve;
- e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në kartelën e shoqërisë.

Neni 12

Përgjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) Dhënien ose jot të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi




7

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

Z. Ignazio Cassano, i biri i Michele, lindur me 24/12/1973 në Bari, banues në Modugno, Via Contrada Conella 38/D, Bari, Itali, identifikuar me numrin e kartës së identitetit nr. AY 2785886

Specimeni i nënshkrimit:



Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tragtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - Përgatisin dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - Kryejnë rregjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare, dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



- Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratores janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë një mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se 1 administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit, pasojat përkatëse

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17 e 18, 19 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet;

1.

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesimin dhe interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendimi;
- d) Të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim



të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme;

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interest apo dividendë;
- c) U shpërndanë aktivet shoqërisë;
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjëndjes financiare duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishtë aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkatuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV **VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

Neni 16 **Viti financiar**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti I parë fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 **Ekspertët**



Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruar, që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve, për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendore që ka.

KREU V

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISE

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) Me vendim të gjykates;


Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë, mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër"

Prishja e shoqërive tregtare ka sipasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese me përgjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo përsone i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja



Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 20 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21 Mosmarrveshjet

Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BIT_Italian technology for building industry” Sh.p.k

Z. Sabino Rutilli


(nënshkrimi)


Z. Ignazio Cassano


(nënshkrimi)

MS Law & Business” Sh.p.k.

Michele Sorgente (administratori)


(vuja, nënshkrimi)

Foqktheu: Simola celeni


KONTRATË PËR PËRCAKTIMIN E KONTRIBUTEVE NË NATYRË

Me këtë marreveshje private, e cila ka cdo efekt ligjor

NDËRMJET

Shoqërisë "MS Law & Business" Sh.p.k. (Person Juridik), me seli në L. Qemal Stafa, Blv. Zogu I, Nr 44, Shkodër, me numer Unik të Identifikimit (NUIS) L67001005H, i përfaqësuar nga administratori, **Z. Michele Sorgente**, identifikuar me numrin e kartës së identitetit AR3480449

dhe

Z. Sabino Rutilli, i biri i Antonios, lindur me 14/07/1961 në Bari, banues Via Alfredo Giovine 43, Bari, Itali, identifikuar me numrin e kartës së identitetit nr AU 4769932

dhe

Z. Ignazio Cassano, i biri i Michele, lindur me 24/12/1973 në Bari, banues në Modugno, Via Contrada Conella 38/D, Bari, Itali, identifikuar me numrin e kartës së identitetit nr. AY 2785886

duke ditur që:

- Që në mes palëve është themeluar shoqëria "BIT_Italian technology for building industry" Sh.p.k;
- Se shoqëria do të merret me përpunim e hekurit dhe çdo gjë tjetër të listuar në statutin e saj;
- "MS Law & Business" Sh.p.k. është nje kompani veçanërisht e dedikuar në administrimin e kompanive dhe ky partner ka njohuri të konsiderueshme në këtë fushë.

Ne konsiderate gjitha thene me siper si një pjesë integrale dhe e konsiderueshme e kësaj kontrate, palët, siç janë identifikuar më sipër, bien dakord si më poshtë.

- 1) Z. Sabino Rutilli dhe Ignazio Cassano do të derdhin kontributin ne para në "BIT_Italian technology for building industry"Sh.p.k, ne shumat e parave të nevojshme per kapitalin themeltar, statutin, në përpjesëtim me vlerën e kuotave perkatese sipas statudit
- 2) "MS Law & Business" Sh.p.k. do të përcjellë në "BIT_Italian technology for building industry"Sh.p.k. njohurite e saj në lidhje me themelimin dhe administrimin e shoqërive.
- 3) "MS Law & Business" Sh.p.k, nuk do të japin para, as për kapital fillestar, as për ndonjë rritje të kapitalit, duke siguruar që perqindja fillestare prej 10%, nuk ulet, qoftë dhe për mbulim humbjesh.
- 4) përvec kësaj "MS Law & Business" Sh.p.k, mund të dalin në cdo moment nga shoqëria dhe pa asnjë motiv, edhe në të gjitha rastet pa paguar asgjë

Tirana 26/01/2017

Law & Business MS Sh.p.k.
AVV. Michele Sorgente



Sabino Rutilli

Ignatius Cassano

**ATTO DI COSTITUZIONE E STATUTO
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
" BIT_ITALIAN TECHNOLOGY FOR BUILDING INDUSTRY" SH.P.K**



1

CAPO I
COSTITUZIONE; DENOMINAZIONE; OGGETTO; DURATA; SEDE

Articolo 1
Data di costituzione, Denominazione ed il Costituente

In base ai principi della libera iniziativa privata, ai sensi del Codice Civile della Repubblica Albanese, ratificato mediante la Legge 29.7.1994 nr. 7850, successivamente modificata, ai sensi, inoltre, della Legge 14.4.2008 n. 9901 "Dei commercianti e delle società commerciali, succ. modificata, della Legge 3.5.2007 n. 9723 "Per registrazione delle imprese", succ. Modificata; nonché della Legge 26.11.2015, n. 131/2015 "Centro Nazionale per il Commercio" (CNC)

1. Addì 26/01/2017 noi, costituenti, costituiamo una società a responsabilità limitata denominata "BIT_Italian technology for building industry" Sh.p.k
2. i costituenti sono:
 - a) Sig. **Sabino Rutilli**, paternità Antonio, cittadino italiano, nato il 14/07/1961 a Bari ed ivi residente all'indirizzo Via Alfredo Giovine 43, Bari, Italia, titolare della propria carta d'identità nr. AU 4769932
 - b) Sig. **Ignazio Cassano**, paternità Michele, cittadino italiano, nato il 24/12/1973 a Bari e residente in Modugno (BA) all'indirizzo Via Contrada Conella 38/D, Bari, Italia, titolare della propria carta d'identità nr. AY 2785886.
 - c) "**MS Law & Business**" Sh.p.k. (Persona giuridica), con sede a L. Qemal Stafa, Blv. Zogu I, Nr 44, Shkoder, con il numero unico di identificazione (NUIS) L67001005H, rappresentata dall'amministratore, **Michele Sorgente**, titolare della propria carta d'identità nr. AR3480449.

Articolo 2
Oggetto sociale

La società svolgerà propria attività con il seguente oggetto:

- Lavorazione e costruzione di carpenteria metallica; import-export
- Lavorazione e commercializzazione di ferro per edilizia; import-export
- Vendita di rete elettrosaldata, profilati e lamiera, nonché produzione e vendita di manufatti in cemento di tipo armato e vibrato e di tipo precompresso;
- Lavori generali di costruzione di edifici di ogni tipo, completi di impianti e di opere connesse ed accessorie;

2



- lavori edili ed impiantistici in genere, quali opere di urbanizzazione, interventi di manutenzione ordinaria, straordinaria, restauro e risanamento conservativo, ristrutturazione edilizia ed urbanistica;
- vendita di materiali ed attrezzature per l'edilizia;
- produzione di calcestruzzi e semilavorati per l'edilizia, nonché di elementi moduli prefabbricati per costruzioni civili e industriali;
- produzione di inerti, conglomerati e tutto quanto estraibile da cave di pietra, oltre che il loro recupero e/o riutilizzo per l'edilizia in genere;
- compravendita, anche frazionata, gestione, amministrazione e appalto di beni immobili anche se non da utilizzarsi per il raggiungimento dello scopo sociale;
- trasporto per conto terzi, da effettuarsi con mezzi propri e/o di terzi;
- reperimento, organizzazione, affidamento a terzi ed esecuzione di trasporti di ogni tipo, sistema, merce o prodotto;
- attività specifica di spedizioniere nazionale ed internazionale, con mezzi propri e/o di terzi;
- gestione di depositi per qualsiasi merce e/o prodotto attinente il settore edilizio.
- La società potrà inoltre realizzare e fornire strumenti, anche informatici, singoli e/o in rete, e modelli per la gestione integrata di tutti i servizi e le opere precedentemente esemplificate al fine di risolvere tutte le esigenze di global service e/o di facility management dei propri clienti. Per il perseguimento degli scopi sociali, la società potrà avvalersi di tutte le agevolazioni fiscali, finanziarie, previdenziali e creditizie previste dalle vigenti leggi agevolative sia nazionali che estere.

La società potrà compiere tutti gli atti occorrenti, ad esclusivo giudizio dell'organo amministrativo, per l'attuazione ed il raggiungimento dell'oggetto sociale e solo per questo fine, e quindi in via del tutto accessoria e non prevalente e non nei confronti del pubblico, potrà:

- compiere operazioni commerciali ed industriali, bancarie, ipotecarie, economiche ed immobiliari;
- ricorrere a qualsiasi forma di finanziamento con istituti di credito, banche e società, concedendo le opportune garanzie reali e personali;
- assumere partecipazioni ed interessenze in società ed imprese.

Articolo 3 Durata

La società svolgerà la propria attività per un indeterminato periodo di tempo, iniziando dalla sua iscrizione al Centro Nazionale per il Commercio.

Articolo 4 Sede

(1) La società avrà sede all'indirizzo: "Komuna e Parisit", Pall. Haxhiu, Shk 3, AP 3/1/3/D, Zone Kadastrale Nr.8260, Numer Pasurie 6/675+3-7, Tirane



3



CAPO II CAPITALE

Articolo 5 Capitale iniziale

- (1) L'iniziale capitale sociale ammonta ai ALL 1,360,000 (un milione e trecentomila e sessanta mila), equivalente ai Eur10,000 (diecimila)
- (2) La partecipazione del socio costituente al capitale iniziale è in proporzione al proprio contributo come segue:
- Il socio costituente **Sabino Rutilli**: possedente 1(una) Quota, le quali rappresentano **45%** del capitale sociale.
 - Il socio costituente **Ignazio Cassano**: possedente 1(una) Quota, le quali rappresentano **45%** del capitale sociale.
 - Il socio costituente **"MS Law & Business" Sh.p.k**: possedente 1(Una) Quota, le quali rappresentano **10 %** del capitale sociale.

Il contributo deli sigg.ri **Sabino Rutilli** e **Ignazio Cassano** è composto da contanti ed è stato interamente non versato.

Il contributo del **"MS Law & Business" Sh.p.k** il cui contributo è in natura, secondo l'accordo concordato tra i soci, collegato a questo statuto in qui **"MS Law & Business" Sh.p.k** dovrà mai conferire denaro, né per il capitale iniziale, né per eventuali aumenti di capitale, senza che il valore percentuale della quota di **"MS Law & Business" Sh.p.k** si diminuisca, né per coprire eventuali perdite; inoltre, **MS Law & Business" Sh.p.k** potrà sempre uscire dalla società, anche senza motivo e, in ogni caso, senza mai pagare nulla.

Articolo 6 Aumento e diminuzione del capitale

Il capitale sociale potrà essere aumentato mediante la sottoscrizione dei parti del capitale iniziale per contributi in contati nonché mediante i contributi in natura. I soci della società a responsabilità limitata valuteranno ogni conferimento di capitale in natura di comune accordo tra loro, ed esprimono i loro valori. Se non è possibile raggiungere un accordo, ogni socio può chiedere al giudice competente, di incaricare un esperto indipendente, con una decisione ad effetto vincolante. L'accordo dei soci o la perizia del esperto deve essere presentata al Centro Nazionale per il Commercio, insieme ad altri dati necessari per la registrazione.

In ogni caso la maggioranza non può costringere un socio per aumentare il suo coinvolgimento nella capitale della società.

La diminuzione del capitale si potrà fare soltanto su decisione dei soci, con le stesse modalità come quelle requisite per la modifica statuto.



4

In tutti i casi la riduzione del capitale ha l'effetto sui tutti i soci, con l'eccezione di "MS Law & Business" Sh.p.k , stipulato sul articolo 5.

Articolo 7

Trasferimento del capitale

Le quote del capitale di una società a responsabilità limitata nonché i diritti derivandosi dalle stesse potranno venire ottenuti oppure trasferiti tramite:

- a) il contributo al capitale sociale;
- b) il loro acquisto;
- c) l'eredità.
- d) la donazione;
- e) ogni altra modalità prevista dalla legge.

Le parti del capitale iniziale sono liberamente trasferibili in via di eredità.

CAPO III

ORGANI DECISIONALI E DI DIRIGENZA

Articolo 8

Organo decisionale

Assemblea Generale è il solo organo decisionale della società.

Assemblea Generale è il decisionale organo sociale cui approva le modifiche dello statuto secondo le modalità definite dalla legge.

Assemblea Generale ha la responsabilità di prendere delle decisioni per le questioni sociali come seguono:

- a) la definizione delle politiche commerciali della società;
- b) la modifica dello statuto;
- c) la nomina ed il licenziamento degli amministratori;
- d) la nomina ed il licenziamento dei liquidanti nonché autorizzati revisori
- e) definizione retribuzioni per le persone succitate ai commi "c" e "d" del presente articolo;
- f) la supervisione d'implementazione delle politiche commerciali dal canto degli amministratori, compresa la preparazione degli annuali specchietti finanziari nonché dei rapporti d'andamento attività.
- g) l'approvazione degli annuali specchietti nonché dei rapporti d'andamento attività;
- h) l'aumento e la diminuzione del capitale;
- i) la divisione delle quote e loro annullamento;
- j) la rappresentazione della società in tribunale nonché ai procedimenti contro l'amministratori.
- k) la riorganizzazione e lo scioglimento società;
- l) le altre questioni previste dalla legge oppure lo statuto;

Un socio può essere rappresentato all'Assemblea generale, sulla base di un'autorizzazione da un altro socio o da una terza persona.



5



L'amministratore dell'azienda non può agire in qualità di rappresentante dei soci nel corso della riunione generale.

L'autorizzazione può essere data solo per una riunione dell'Assemblea Generale, incluso anche la riunione successiva con lo stesso ordine del giorno.

Articolo 9

Convocazione della riunione dell'Assemblea Generale

1. Assemblea Generale convocata mediante avviso per iscritto o, previa notifica per posta elettronica. L'avviso, e-mail deve contenere il luogo, la data e l'ora della riunione e l'ordine del giorno da inviare tutti i membri entro e non oltre 7 giorni prima della data fissata per la riunione.
2. Qualora l'assemblea generale non è stata convocata come al paragrafo 1 del presente articolo, può prendere decisioni valide solo se tutti i soci si impegnano a prendere decisioni, a prescindere dalla irregolarità.

Articolo 10

Quorum

Nel caso di decisioni che richiedono la maggioranza dell'assemblea generale ordinaria può prendere decisioni solo se partecipano i soci con il diritto di voto, che possiedono più del 30% delle quote.

Nel caso in cui l'assemblea generale delibera nelle materie che richiedono una maggioranza qualificata di cui all'articolo 87 della legge "dei Imprenditori e società commerciali", si può prendere decisioni valide solo se i soci che possiedono più della metà del numero totale di voti, sono presenti di persona, votano per iscritto o per posta elettronica, secondo le disposizioni del paragrafo 3 dell'articolo 88 della presente legge.

Se l'Assemblea Generale non può essere considerato per l'assenza del quorum sopra menzionato, la riunione si riconvocata entro e non oltre 30 giorni, con lo stesso ordine del giorno.

Articolo 11

Decisioni

L'Assemblea Generale decide con tre quarti dei voti dei detentori del capitale per modificare lo statuto, aumento o riduzione del capitale sociale, distribuzione degli utili, la riorganizzazione e la dissoluzione.

Assemblea Generale decide con la maggioranza dei voti dei membri partecipanti su questioni come:

- a) Determinazione delle politiche aziendali;
- b) la nomina e la revoca degli amministratori;
- c) la nomina e la revoca esperto e revisore contabile;
- d) Determinazione del compenso;
- e) La vigilanza l'attuazione delle politiche aziendali da parte degli amministratori, compresa la preparazione dei bilanci annuali e delle relazioni di prestazioni di attività;
- f) Rappresentare la società in tribunale e in altri procedimenti contro gli amministratori;
- g) L'adozione di regole di procedura delle assemblee generali;



6



Ogni modifica effettuata allo statuto deve venire depositata presso il CNC per rispecchiare i cambiamenti nel rispettivo fascicolo della società.

Articolo 12

Esclusione dal diritto di voto

1. Il socio non può esercitare il diritto di voto se l'Assemblea Generale decide su:
 - a) Valutazione dell'attività sua;
 - b) Soppressione di qualsiasi responsabilità nei suoi confronti;
 - c) La creazione di una causa contro di lui da parte della società;
 - d) Concessione o richiesta di nuovi benefici
2. Qualora socio viene rappresentato da un mandatario, o altra persona autorizzata, che si ritiene di essere nella stessa situazione di conflitto di interessi del socio che rappresenta.


Articolo 13

Amministrazione

- (1) Assemblea Generale fa nominare uno o più persone fisiche quali amministratori sociali. Il termine di nomina è di 5 anni col diritto di rinnovo. La nomina degli amministratori produce effetti dopo l'iscrizione al Centro Nazionale per il Commercio.
- (2) Gli amministratori di una società controllante ai sensi dell'articolo 207 della presente legge, non possono essere nominati come amministratore di una società controllata e viceversa. Ogni intesa realizzata in violazione di tali disposizioni è nulla.
- (3) Le seguenti persone si nominano quale amministratore sociale:

1. Sig. **Ignazio Cassano**, paternità Michele, cittadino italiano, nato il 24/12/1973 a Bari e residente in Modugno all'indirizzo Via Contrada Conella 38/D, Bari, Italia, titolare della propria carta d'identità nr. AY 2785886.

- Lo specimen della propria firma:




Articolo 14

Competenze

L'amministratore sociale ha i seguenti diritti ed obblighi:

- a) di effettuare tutte le azioni di amministrazione dell'attività commerciale sociale, ottemperando alle politiche commerciali prefissate dal socio;
- b) di rappresentare la società;
- c) fa attenzione per il mantenimento regolare dei documenti e contabili libri sociali;
- d) prepara e sottoscrive il bilancio annuo, il bilancio consolidato nonché il rapporto d'andamento dell'attività e quindi, associati con le proposte di distribuzione utili, presenta i succitati documenti all'unico socio per approvazione;



- e) crea un sistema di tempestivo preavviso sulle circostanze che arrischiano il buon andamento dell'attività ed, addirittura, l'esistenza della società.
- f) fa le registrazioni nonché inoltra i dati obbligatori della società, come previsto dalla legge del CNC;
- g) riferisce, dinanzi ai soci, riguardo all'osservanza delle politiche commerciali nonché all'adempimento dei speciali doveri di particolare importanza;

L'amministratore sarà obbligato di convocare l'assemblea dei soci nei casi in cui:

- secondo il bilancio annuo o gli intermedi rapporti finanziari, risulta oppure esiste il rischio che gli attivi sociali non coprano i richiesti obblighi entro 3 mesi ed in seguito;
- la società propone di vendere oppure disporre attivi in altri modi, i quali hanno un valore che supera i 5% degli attivi sociali i quali risultano nei specchietti finanziari di fine esercizio finanziario certificati.

Nel caso in cui i soci nominano più amministratori, i medesimi fanno congiuntamente l'amministrazione sociale.

I soci potranno licenziare l'amministratore in ogni tempo. Le querele che hanno a che fare con la remunerazione dell'amministratore, si fanno regolarmente in conformità alle vigenti norme legali


Articolo 15 **Responsabilità dell'amministratore**

L'amministratore sarà individualmente responsabile nei confronti della società oppure degli altri per la violazione leggi, per trasgressione statuto, oppure per degli errori commessi durante l'amministrazione sociale.

Le conseguenze degli accordi non approvati dall'assemblea che possono danneggiare la società, si metteranno a carico dell'amministratore individualmente.

Salvo a quanto previsto nelle clausole generali sull'obbligo fedeltà, ai sensi degli art. 14, 15, 17, e 19 della Legge "Dei commercianti e delle società commerciali", l'amministratore sarà obbligato:

1. a) di svolgere i propri compiti stabilite dalla legge eppure dallo statuto in buona fede e secondo il miglior interesse della società, facendo speciale attenzione all'impatto ambientale dell'attività sociale;
 - b) di esercitare le competenze al medesimo riconosciute dalla legge e dallo statuto soltanto per l'adempimento dei fini stabiliti nelle summenzionate norme;
 - c) di valutare rigorosamente le questioni sulle quali si prendono decisioni;
 - d) di non avere ed evitare casi di personale conflitto d'interesse, presente oppure possibile, con la società.
 - e) di svolgere i propri compiti con l'adeguata professionalità ed attenzione.
2. L'amministratore, durante lo svolgimento dei propri doveri, da conto alla società per ogni azione oppure omissione ragionevolmente in relazione con i fini della stessa, salvo i casi in cui, in base alle indagini e valutazioni di rispettive informazioni, l'azione oppure l'omissione sia stata fatta in buona fede.
3. Nel caso in cui l'amministratore agisce inadeguatamente oppure trasgredisce gli standard professionali, secondo i commi 1 e 2 del presente articolo, il medesimo sarà obbligato a



indennizzare la società nonché restituirle ogni provento che il medesimo oppure le persone complici hanno realizzato. L'amministratore ha l'obbligo di evidenziare il corretto adempimento secondo gli standard dei propri compiti. Se la violazione è commessa da più di un amministratore saranno responsabili in modo solidale nei confronti di società.

4. In modo particolare, ma senza limitarsi in solo questo, l'amministratore sarà obbligato a risarcire la società di danni, nel caso in cui, violando le norme della Legge "Dei commercianti e delle società commerciali", esegue le seguenti azioni:

- a) restituisce i contributi al socio;
- b) retribuisce al socio degli interessi oppure dividendi;
- c) distribuisce gli attivi sociali;
- d) permette che la società continui l'attività commerciale mentre, in base alla situazione finanziaria, dovrebbe invece prevedere che la società non avrebbe avuto capacità di liquidazione.
- e) presta crediti;

A parte della querela civile per l'indennizzo al carico dell'amministratore, i soci riserveranno il diritto a sporgere pure querela penale contro il medesimo.

CAPO IV

Articolo 16 Esercizio finanziario

L'esercizio finanziario della società inizia al 1° gennaio e termina il 31 dicembre. In modo eccezionale, il primo esercizio finanziario inizia dal giorno d'iscrizione della società nel CNC e si chiude il 31 dicembre.

Articolo 17 Revisori

L'esperto ha il compito di controllare tutta la documentazione contabile della economico-commerciale attività sociale in modo annuale nonché quando periodicamente richiesto ed incaricato dall'unico socio.

Al termine della revisione, l'autorizzato revisore redige il rapporto scritto sugli esiti del bilancio dell'esercizio finanziario ovvero quello sugli esiti controllo periodico intrapreso, i quali devono essere avanzati tempestivamente all'unico socio per la loro valutazione e approvazione in base al diritto decisionale di quest'ultimo.



CAPO V
Scioglimento - riorganizzazione sociale

Articolo 18
Scioglimento e liquidazione

Lo scioglimento oppure la cancellazione della società si potrà fare in ogni tempo:

- a) su decisione dell' Assemblea Generale;
- b) con l'inizio di procedure fallimentari;
- c) Nel caso in cui non abbia operato attività commerciale durante due consecutivi anni non essendo comunicato la sospensione attività sociale ai sensi del comma 3 dell'art. 43 Legge 3.5.2007 nr. 9723 "Del Centro Nazionale per il Commercio".
- d) con sentenza del tribunale.

In questo caso i Soci decidono in forma scritta mediante cui prescrive la modalità di liquidazione società, assegnando 1 o più revisori ed annotando su ogni documento estratto dal medesimo il nome del revisore e la nota "Società in corso di liquidazione".

La liquidazione si effettua dal liquidatore nominato dai soci.

Nel caso in cui i soci non prendano una decisione su assegnazione dei liquidanti, ogni persona interessata potrà indirizzarsi, entro 30 giorni in seguito allo scioglimento, al tribunale si assegnare un liquidante.

Articolo 19
Riorganizzazione sociale; fusione, divisione

La società potrà venire divisa o fusa su decisione dell' Assemblea Generale ai sensi delle norme legali previste alla parte IX della Legge 14.4.2008 n. 9901 "Dei commercianti e delle società commerciali".

Articolo 20
Base legale

La società svilupperà la propria attività in piena conformità con il presente contratto di costituzione nonché con le vigenti norme legali albanesi.

Per quanto non previsto al presente contratto di costituzione, verranno ottemperate le disposizioni dello statuto, della Legge "Dei commercianti e delle società commerciali", del C.C. nonché di ogni altra legge inerente dell'ordinamento di Repubblica Albanese.



**Articolo 21
Controversie**

Per le controversie che potranno emergere in riguardo all'ottemperanza oppure all'interpretazione del presente statuto, nonché per ogni contrasto che potrà emergere tra la società ed i terzi, sarà competente il Tribunale Albanese.

I SOCI
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
"BIT_Italian technology for building industry" Sh.p.k

Z. Sabino Rutilli

(firma) 

Z. Ignazio Cassano

(firma) 

MS Law & Business" Sh.p.k.

Michele Sorgente (amministratore)

(timbro, firma) 


CONTRATTO DI CONFERIMENTO BENI IN NATURA

Con la presente scrittura privata, da valersi ad ogni effetto di legge

TRA

MS Law & Business” Sh.p.k. (Persona giuridica), con sede a L. Qemal Stafa, Blv. Zogu I, Nr 44, Shkoder, con il numero unico di identificazione (NUIS) L67001005H, rappresentata dall'amministratore, Avv. **Michele Sorgente**, titolare della propria carta d'identità nr. AR3480449.

E

Sabino Rutilli, paternità Antonio, cittadino italiano, nato il 14/07/1961 a Bari ed ivi residente all'indirizzo Via Alfredo Giovine 43, Bari, Italia, titolare della propria carta d'identità nr. AU 4769932

E

Ignazio Cassano, paternità Michele, cittadino italiano, nato il 24/12/1973 a Bari e residente in Modugno (BA) all'indirizzo Via Contrada Conella 38/D, Bari, Italia, titolare della propria carta d'identità nr. AY 2785886.

Premesso che

- che tra i suddetti è costituita la “BIT_Italian technology for building industry” Sh.p.k;
- che detta società si occuperà di lavorazioni del ferro e di quant'altro elencato nel suo statuto;
- che MS Law & Business Sh.p.k. è società particolarmente dedicata alla gestione delle società ed il suo socio vanta un notevole know how in materia.

tutto ciò premesso

e ritenuto parte integrante e sostanziale del presente contratto, le parti, come sopra individuate, convengono e stipulano quanto segue.

- 1) I signori Sabino Rutilli e Ignazio Cassano conferiranno nella “BIT_Italian technology for building industry” Sh.p.k. le somme di denaro necessarie o indicate negli atti sociali, in proporzione al valore delle proprie quote.
- 2) MS Law & Business Sh.p.k. conferirà nella “BIT_Italian technology for building industry” Sh.p.k. esclusivamente il proprio know how in materia di costituzione e gestione delle società.
- 3) MS Law & Business Sh.p.k., non dovrà mai conferire denaro, né per il capitale iniziale, né per eventuali aumenti di capitale, senza che il valore percentuale della quota di 10%, di “**MS Law & Business” Sh.p.k** si diminuisca, né per coprire eventuali perdite;
- 4) inoltre MS Law & Business Sh.p.k., potrà sempre uscire dalla società, anche senza motivo non e, in ogni caso, senza mai pagare nulla.

Tirana 26/01/2017

MS Law & Business Sh.p.k.
Avv. *Michele Sorgente*



Sabino Rutilli

Ignazio Cassano